

GJYKATA E QARKUT NË MITROVICË

P. nr. 17/09

7 Tetor 2010

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E QARKUT NË MITROVICË, në trupin gjykues të përbërë nga Gjykatësi i EULEX-it Charles Smith si Kryetar i Trupit Gjykues, dhe Gjykatësit e EULEX-it Caroline Charpentier dhe Agnieszka Klonowiecka-Milart si anëtarë të trupit gjykues, me pjesëmarrjen e Oficeres Ligjore të EULEX-it Noora Aarnio si Oficere Regjistruese në rastin penal ndaj;

Njazi MULA, i akuzuar, sipas Aktakuzës së Prokurorit PP. Nr. 98/08 të datës 20 Shkurt 2009 dhe të deponuar në Zyrën e Regjistrimit të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë me 24 Shkurt 2009 dhe të ndryshuar me 17 Shkurt 2010, e konfirmuar me Aktvendimin mbi Konfirmim të Aktakuzës me datën 19 Shkurt 2010, për vepra penale siç vijojnë;

- **Vrasje**, në kundërshtim me Nenin 146 lidhur me Nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës (KPK),
- **Mbajtja në Pronësi, në Kontroll, në Posedim apo Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve**, në kundërshtim me Nenin 328, paragrafi 2 të KPK,

Rasim SHALA, i akuzuar, sipas Aktakuzës së Prokurorit PP. Nr. 98/08 të datës 20 Shkurt 2009 dhe të deponuar në Zyrën e Regjistrimit të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë me 24 Shkurt 2009 dhe të ndryshuar me 17 Shkurt 2010, e konfirmuar me Aktvendimin mbi Konfirmim të Aktakuzës me datën 19 Shkurt 2010, për vepra penale siç vijojnë;

- **Vrasje**, në kundërshtim me Nenin 146 lidhur me Nenin 23 të KPK,
- **Mbajtja në Pronësi, në Kontroll, në Posedim apo Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve**, në kundërshtim me Nenin 328, paragrafi 2 të KPK,

Pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik me 4, 5, 6 dhe 7 Tetor 2010 të gjitha në prani të të akuzuarve Njazi Mula dhe Rasim Shala, Avokatëve të tyre Mbrojtës Bajram Krasniqi dhe Haxhi Millaku, Palës së Dëmtuar Ramiz Shabani, Përfaqësuesit të Autorizuar të Palës së Dëmtuar Xhelal Hasani dhe Prokurores Publike të EULEX-it Neeta Amin, pas pleqërimit nga trupi gjykues dhe votimit të mbajtur me 7 Tetor 2010, shpalli në pajtim me Nenin 392 paragrafi (1) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) – të njëjtën ditë – publikisht dhe në prani të të Akuzuarve, Avokatëve të tyre Mbrojtës, Palës së Dëmtuar, Përfaqësuesit të tij të Autorizuar dhe Prokurorit Publik të EULEX-it siç vijon

AKTGJYKIM

I akuzuari **Njazi Mula**, pa nofkë, i biri i Fetah Mula dhe Hamide Gashi, i lindur me 17 Nëntor 1976 në Fshatin Kllodernicë, komuna e Skenderjat, i martuar, baba i tre fëmijëve, arsimimi më i lartë shkolla e mesme, i papunë, i gjendjes së dobët ekonomike, pa dënime të njohura të mëparshme, në paraburgim nga 2 Shtatori 2008 deri me 17 Shkurt 2010, dhe më pastaj nën masën e arrestit shtëpiak

SHPALLET FAJTOR

- **sepse** me 2 Shtator 2008 në mëngjes kishte pasur një konflikt në mes të pandehurve Njazi Mula dhe Rasi Shala në njërën anë dhe dëshmitarit Ramiz Shabani në anën tjetër. Tafil Shabani, i vëllai i Ramiz Shabanit, ka thirrur të pandehurit Njazi Mula dhe Rasim Shala që të takohen dhe të zgjidhin konfliktin. Ata organizojnë një takim rreth orës 17:00 në parkingun e Restorant Elinda 2 në fshatin Polac, komuna e Skenderajt. Njazi Mula dhe Rasim Shala ngisnin një veturë Golf 2. Tafil Shabani dhe Burim Hajdini ngisnin një veturë Opel Vectra. Njazi Mula kishte armën TTM-57 me numër serik 863307 dhe Rasim Shala kishte armën TTM-57 me numër serik C57818. Njazi Mula të paktën drejton armën e tij në Tafil Shabanin. Tafil Shabani nxjerr armën AK të kalibrit 7,62 x 39 mm me numër serik 7948-1 dhe e drejton atë në Rasim Shalën. Rasim Shala lëviz në drejtim të Tafil Shabanit dhe kap pushkën e Tafil Shabanit. Gjatë përleshjes pushka zbrazet ku si rezultat qëllohet Rasim Shala në këmbë. Njazi Mula qëllon disa herë në Tafil Shabanin. Tafil Shabani merr një plumb në anën e majtë të gjoksit nga të shtënat nga Njazi Mula. Të dy Tafil Shabani dhe Rasim Shala bien në tokë për shkak të lëndimeve të marra. Njazi Mula provon të largohet nga vendi i ngjarjes. Gjendja e Tafil Shabanit përkeqësohet nga dëmtimet në organet e brendshme të shkaktuara nga e shtëna në gjoks dhe ai vdes të njëjtën ditë. Rasim Shala kishte pësuar lëndime serioze nga e shtëna me armë në këmbë dhe krah. Si pasojë i pandehuri Njazi Mula ka privuar nga jeta të ndjerin Tafil Shabanin.

Me këtë veprim i akuzuari Njazi Mula ka kryer dhe është përgjegjës penalisht për veprën penale të **Vrasjes**, në kundërshtim me Nenin 146 lidhur me Nenin 23 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës(KPPK),

I akuzuari **Njazi Mula**,

SHPALLET FAJTOR

- **sepse** deri me datën 2 Shtator 2008 ai ka pasur në posedim joligjor armën TTM-57 të kalibrit 7,62 me numër serik 863307.

Me këtë veprë i akuzuari Njazi Mula ka kryer dhe është përgjegjës penalisht për veprë penale të **Mbajtjes në Pronësi, në Kontroll, në Posedim apo në Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve**, në kundërshtim me Nenin 328, Paragrafi (2) të KPPK.

I akuzuari **Rasim SHALA**, pa nofkë, i biri i Milazim Shalës dhe Zahide Haxhës, i lindur me 15 Janar 1971 në Fshatin Kopiliq i Ulët, komuna e Skenderajt, Kosovë, Shqiptar etnik, banor në fshatin Kopiliq i Ulët, komuna e Skenderajt, i martuar, baba i 3 fëmijëve, arsimimi më i lartë shkolla e mesme teknike, i papunë (invalid), i gjendjes së dobët ekonomike, pa dënime të njohura të mëparshme, nuk ka qenë nën ndonjë masë sigurie

SHPALLET I PAFAJSHËM

- **sepse, siç përshkruhet më lartë** ai nuk ka privuar nga jeta të ndjerin Tafil Shabani në bashkëkryerje me të pandehurin Njazi Mula.

Prandaj, në përputhje me Nenin 390 paragrafi 3 të KPPK i akuzuari Rasim Shala **lirohet** nga akuza e **Vrasjes**, në kundërshtim me nenin 146 lidhur me Nenin 23 të KPK.

I akuzuari **Rasim Shala**,

SHPALLET FAJTOR

- **sepse** deri me datën 2 Shtator 2008 ai ka pasur në posedim joligjor armën TTM-57 të kalibrit 7,62 me numër serik C57818.

Me këtë veprim i akuzuari Rasim Shala ka kryer dhe është përgjegjës penalisht për veprë penale të **Mbajtjes në Pronësi, në Kontroll, në Posedim apo në Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve**, në kundërshtim me Nenin 328, Paragrafi (2) të KPPK.

I Akuzuari **Njazi Mula**,

DËNOHET

- me 5 /pesë/ vite burgim për veprë penale të Vrasjes.

- me 4 /katër/ vite burgim për vepër penale të Mbajtjes në Pronësi, në Kontroll, në Posedim apo në Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve.

Dënimi unik është vendosur të jetë **7 /shtatë/ vite burgim**, në përputhje me Nenin 71 Paragrafi (1) dhe Paragrafi (2) Pika 2 të KPPK.

Koha e vuajtur në paraburgim nga 2 Shtatori 2008 deri me 17 Shkurt 2010, pas kësaj nën masën e arrestit shtëpiak do të kreditohet në përputhje me Nenin 73 Paragrafi (1).

I Akuzuari Rasim Shala,

DËNOHET

- me 2 /dy/ vite burgim për vepër penale të Mbajtjes në Pronësi, në Kontroll, në Posedim apo në Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve

Në këtë mënyrë arma TTM-57 e kalibrit 7,62 me numër serik 863307, arma TTM-57 e kalibrit 7,62 me numër serik C57818 konfiskohen në pajtim me nenin 60 Paragrafi (1) dhe Nein 328 Paragrafi (5) të KPPK. Arma AK e kalibrit 7,62 x 39 mm me numër serik 7948-1 e gjetur dhe e konfiskuar në të njëjtin rast do të kthehet me një urdhër të veçantë në momentin që pronari legjitim apo përfaqësuesi i Autorizuar paraqet kartën e vlefshme të autorizimit.

I akuzuari Njazi Mula dhe i akuzuari Rasim Shala do të kompensojnë pjesët e tyre të kostos së procedurës penale në pajtim me Nenin 102 Paragrafi (1) të KPPK me përjashtim të kostos së përkthimit dhe interpretimit. Një aktvendim i veçantë lidhur me shumën e kostos do të merret nga gjykata kur të dhënat e tilla të sigurohen në përputhje me Nenin 100 Paragrafi (2) të KPPK.

ARSYETIMI

A. PRAPAVIJA PROCEDURALE – AKTAKUZA

Me 24 Shkurt 2009, Prokurori Publik i Qarkut në Mitrovicë ka deponuar aktakuzën PP. No. 98/08 të datës 20.02.2009 në Zyrën e Regjistrimit në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë. Aktakuza pretendon që i pandehuri Njazi Mula ka kryer veprat penale të

- **Vrasje**, në kundërshtim me Nenin 146 lidhur me Nenin 23 të KPK
- **Mbajtja në Pronësi, në Kontroll, në Posedim apo në Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve**, në kundërshtim me Nenin 328 paragrafi 2 të KPK.

Aktakuza pretendon që i pandehuri Rasim Shala ka kryer veprat penale të

- **Vrasje**, në kundërshtim me Nenin 146 lidhur me Nenin 23 të KPK
- **Mbajtja në Pronësi, në Kontroll, në Posedim apo në Shfrytëzim të Paautorizuar të Armëve**, në kundërshtim me Nenin 328 paragrafi 2 të KPK

Aktakuza është modifikuar me 17 Shkurt 2010 por cilësimet ligjore të akteve kriminale për Mulën dhe Shalën mbetën të njëjta.

Aktakuza e ndryshuar është konfirmuar me Aktvendimin e Gjykatës për Konfirmim të EULEX-it me 19 Shkurt 2010.

Janë mbajtur seanca të Shqyrtimit Kryesor me 4, 5, 6 dhe 7 Tetor 2010. Fjalët përfundimtare nga Prokurorja e EULEX-it Neeta Amin, Avokatët Mbrojtës Bajram Krasniqi dhe Haxhi Millaku janë dëgjuar me 7 Qershor 2010. Aktgjykimi është shpallur gojarisht të njëjtën ditë.

B. KOMPETENCAT E GJYKATËS

Sipas Nenit 23 Pika 1) i) të KPPK, gjykatat e qarkut janë kompetente për të shqyrtuar rastet penale që përfshijnë akuzat për të cilat ligji lejon dhënien e dënimeve penale me më së paku pesë vite. Në pajtim me Nenin 27 paragrafi (1) të KPPK, kompetenca territoriale është e duhur me gjykatën në qarkun e të cilës pretendohet të jetë kryer krimi.

Siç është cekur më lartë, akuzat e Vrasjes sipas Nenit 146, lejon dhënien e dënimit me burgim me më së paku pesë vite, Për më tepër aktakuza në këtë rast pretendon që të akuzuari kanë kryer veprat në Polac, Skenderaj.

Prandaj, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë është organ gjyqësor kompetent të shqyrtoj këtë procedurë penale.

Me 18 Nëntor 2009, Kryetarja e Asamblesë së Gjykatësve të EULEX-it ka ushtruar të drejtën e saj që të caktoj gjykatës të EULEX-it për rastet që bien nën kompetencat suplementare të gjykatësve të EULEX-it në pajtim me Nenin 3.3 të “Ligjit mbi Kompetencat, Përzgjedhjes së Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve Gjykatësve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë” dhe ua ka caktuar këtë rast Gjykatësve të EULEX-it në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë.

C. Përmbledhje e Provave të Paraqitura

Gjatë rrjedhës së shqyrtimit kryesor janë dëgjuar dëshmitarët siç vijojnë:

- (1) Ramiz Shabani– Palë e Dëmtuar, 4 Tetor 2010
- (2) Burim Hajdini – Dëshmitar, 5 Tetor 2010
- (3) Nazmi Leku – Dëshmitar, 5 Tetor 2010
- (4) Fadil Xani – Dëshmitar, 6 Tetor 2010
- (5) Shemsedin Geci – Dëshmitar, 6 Tetor 2010
- (6) Shkelzen Selimi – Dëshmitar, 6 Tetor 2010

Gjatë rrjedhës së shqyrtimit kryesor, dokumentet siç vijojnë janë lexuar dhe kanë hyrë si prova:

- (7) Raporti Fillestar i Incidentit i datës 2 Shtator 2008
- (8) Raporti mbi Bastisjen e shtëpisë dhe personave (Mula) të datës 2 Shtator 2008
- (9) Raporti mbi Bastisje e shtëpisë dhe personave (Shala) të datës 2 Shtator 2008
- (10) Shemsedin Geci SHPK – Raporti i Oficerit i datës 2 Shtator 2008
- (11) Hazir Haziri SHPK – Raporti mbi Inspektimin e Vendit të Ngjarjes, me fotografi të bashkëngjitura i datës 2 Shtator 2008
- (12) Selman Mecini SHPK - Vehbi Mangjollli SHPK- Raporti i oficerëve i datës 3 Shtator 2008
- (13) Bajram Recaj SHPK – Raporti i Oficerit i datës 3 Shtator 2008
- (14) Lulzim Geci SHPK – Raporti i Hetuesit i datës 3 Shtator 2008
- (15) Kasim Osmani – Kallëzimi Penal i datës 5 Shtator 2008
- (16) Hazir Haziri SHPK – Raporti mbi inspektimin vendit të ngjarjes, me fotografi të bashkëngjitura i datës 5 Shtator 2008
- (17) Kasim Osmani SHPK – Drejtoria e Forenzikës, Sektori i vendit të ngjarjes, Kërkesa, e padatuar
- (18) Dosja e Identifikimit Forenzik #08-094 duke përfshirë fotografi
- (19) Arben Plana – Raporti i hetuesit i datës 10 Shtator 2008
- (20) Rrahim Berbatovci – Raporti i Autopsisë i datës 3 Shtator 2008
- (21) Dr. Prasanna Dassanayake – Raporti i Autopsisë i datës 3 Shtator 2008 duke përfshirë fotografi të bashkëngjitura
- (22) Shënimet e Mjekut për të lënduarin Rasim Shala i datës 2 Shtator 2008
- (23) Kopje e shënimeve të Mjekut e padatuar
- (24) Hysni Shala – Përshkrim i përmbajtjes së dosjes së lëndës
- (25) Lista e provave
- (26) Zinxhiri i mbajtjes
- (27) Lutfi Rraci SHPK – Raporti e ekzaminimit kriminalistik
- (28) Enes Kalludra – Raporti i analizës së ekspertit, duke përfshirë formularin e analizës së ekspertit të Laboratorit Qendror të Kriminalistikës/Formularin e Analizës (B), Ekspertiza nga Laboratori Qendror i Forenzikës/Formulari i Analizës (A), Shablloni për Ekzaminimin Forenzik të Laboratorit të SHPK-së

- (A) dhe Shablloni për Ekzaminimin Forenzik të Laboratorit të SHPK-së (B), të padatuara
- (29) Flurim Sahitaj – Raporti i ekzaminimit forenzik, sektori i daktiloskopisë, duke përfshirë kërkesën për Ekspertizë/Analizë të Provave në Laboratorin Qendror të Forenzikës (A) dhe kërkesën për Ekspertizë/Analizë të Provave në Laboratorin Qendror të Forenzikës (B) të datës 27.11.2008
 - (30) Hysni Shala SHPK – Raporti nga inspektimi i vendit të ngjarjes i datës 4 Shtator 2010
 - (31) Flamur Fetahu SHPK- Raporti Identifikues i Forenzikës duke përfshirë skicën e vendit të ngjarjes dhe mbulesa e albumit fotografik të datës 3 Shtator 2008

Gjatë seancës së shqyrtimit kryesor me 6 Tetor 2010 i Akuzuari Njazi Mula është përgjigjur në pyetje. Rasim Shala ka ushtruar të drejtën e tij të mos jap deklaratë. Kërkesa e Avokatit Mbrojtës Xhelal Hasani që deklarata e Kasim Xanit të konsiderohet si e lexuar është pranuar.

Ramiz Shabani palë e dëmtuar, ka cekur në deklaratën e tij që ai ishte duke punuar si tetar në Brigadën e 2-të të Gardës së Kosovës (TMK) në Blinajë, komuna e Lipjanit. Njazi Mula ishte zëvendës komandant i brigadës. Rasim Shala ishte komandant i drejtpërdrejtë i Ramiz Shabanit. Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Shalës ishte Komandanti Bekim Osmani, Mula ishte zëvendës komandant. Nga periudha 2005 deri tek incidenti Ramiz Shabani dhe Shala kurrë nuk kanë pasur ndonjë mosmarrëveshje pas orarit të punës.

Dëshmia e Shabanit është marrë thjesht me natyrën e konfliktit. Një muaj para vrasjes ka dalë një konflikt rreth orarit të punës. Shabani e kishte thënë mendimin e tij rreth orarit të punës para tërë kazermës. Mula është kundërpërgjigjur para tërë kazermës se do ta përjashtoj Shabanin. Mula nuk e ka pasur këtë të drejtë. Dy apo tre ditë para vrasjes që është çështje e kësaj lënde, ka lindur një konflikt në mes Shabanit, Shalës dhe Mulës, përsëri lidhur me orarin e punës. Shabani donte të largohej nga puna më herët që ti ndihmoj gruas së tij të kujdesej për fëmijën e sëmurë. Mula dhe Shala refuzuan kërkesën e tij të përsëritur. Ai shkon në shtëpi pa leje, gjë që nuk e kishte bërë më parë.

Me 2 Shtator Shabani thirret në zyrë të Shalës. Pas hyrjes ai ulet pranë Shalës dhe qëndron i ulur deri sa të hyj Mula. Shala ishte në një gjendje të ashpër dhe gojarisht e ballafaqon Shabanin duke e akuzuar si “dallaveraxhi” të cilën Shabani e merr si shumë ofenduese. Shala e pyet Shabanin pse ishte larguar nga kazerma më herët atë ditë të cilës iu referova më herët. Shabani heton një TT tip të pistoletës të zezë në një sirtar të hapur afër Shalës. Shabani kurrë nuk i kishte sulmuar oficerët superior të tij, por thotë që është sulmuar nga ta më përpara. Ai frikohej se nëse do të provonte të përdori ndonjë forcë kundër Shalës, Shala do ta qëllonte. Shabani ishte i paarmatosur.

Mula pastaj hyn në dhomë me pistoletën e tij TTM-57 që shihej në rripin e tij. Ai e kishte dorën e tij në dorëzën e pistoletës. Ai ishte qartë i zemëruar dhe përmendi shkarkimin e një anëtari nga kazerma e Blinajës. Shabani dyshonte se ata ishin duke folur lidhur me të. Mula iu adresua dhe e pyeti Shabanin në të njëjtën mënyrë sikurse bëri Shala. Shabani

provoi të shpjegoj nevojën për mungesën e tij. Mula e akuzon për trillimin e kësaj arsyeje. Kjo kulmon që Mula të godas me shuplakë në fytyrë Shabanin. Shala ishte duke qëndruar rreth një metër nga Shabani. Pasi i është dukur Shabanit që Mula ishte duke nxjerrë armën e tij, Shabani largohet nga zyra dhe derisa ishte duke dalë njëri ose Mula ose Shala e kanë shkëlmuar nga prapa. Ai nuk e dinte se kush nga ta e kishte shkëlmuar atë.

Shabani donte të depononte një ankesë kundër Shalës dhe Mulës. Anëtarët e komisionit disiplinor në kazermë ishin Shala dhe Mula dhe kështu Shabani nuk kishte zgjidhje por të bëjë ankesën në zyrën e Komandantit Osmani. Ai i thotë Osmanit se ishte sulmuar fizikisht nga Mula dhe Shala dhe me një armë. Osmani i thotë Shabanit se e kupton që tre anëtarë janë larguar nga kazerma pa leje dhe se ua kishte falë pasi me siguri kanë pasur arsye të mira për të bërë këtë. Osmani refuzon kërkesën e Shabanit që çështja të i referohet inspektorit për rend publik dhe i thotë Shabanit që kjo është çështje private dhe se Shabani duhet të merret me të. Në këtë moment Shala hyn në zyrën e Osmanit. Shabani kërkon nga Osmani leje daljeje pasi ndjehej i kërcënuar. Osmani pajtohet për leje edhe pse Shala e kundërshton këtë. Shabani del jashtë zyrës dhe brenda pesë minutash Shala ia sjell atij lejen e daljes. Shabani shkon në shtëpi.

Rrugës për në shtëpi Ramiz Shabani rastësisht takohet me nipin e tij Burim Hajdinin. Hajdini ishte duke ngarë veturën e babait të tij. Ata vozitën në vetura të ndara deri te shtëpia e Hajdinit që ti mundësohej Hajdinit ta lër veturën e tij aty. Ramiz Shabani nuk i kishte treguar atij lidhur me incidentin me Mulën dhe Shalën.

Në Drenas Ramiz Shabani sheh Lekun që qëndron para një mekaniku, veshur me uniformë. Ramiz Shabani e pyet Lekun nëse ai është larguar nga kazerma pa leje. Leku thotë që është larguar me leje pasi kishte një prishje në friksionin e veturës së tij. Ramiz Shabani i tregon Lekut se ishte larguar më herët dhe se Shala dhe Mula e kishin sulmuar. Shabani thotë se Lekut i vinte keq që dëgjoji për këtë. Hajdini ishte në një veturë tjetër dhe nuk ka pasur mundësi të dëgjoj se çka janë duke folur Ramiz Shabani dhe Leku. Pas bisedës Leku rri në dyqanin e tij dhe Ramiz Shabani e Hajdini vazhdojnë në drejtim të Terstenikut.

Pasi Ramiz Shabani dhe Hajdini e lënë veturën në Terstenik ata kthehen te dyqani i mekanikut të Lekut në veturën e Ramiz Shabanit. Ramiz Shabani ka parë Shalën dhe Mulën aty në uniformat e tyre duke folur me Lekun, dhe kështu ata nuk u bashkohen atyre. Ai shkon për kafe me Hajdinin dhe pastaj shkojnë te shtëpia e Ramiz Shabanit.

Në shtëpinë e tij Ramiz Shabani takon një elektrikist dhe vëllanë e tij Tafil Shabanin. Tafil Shabani e pyet Ramiz Shabanin pse kishte ardhur në shtëpi më herët. Ramiz Shabani i tregon atij se kishte pasur probleme me Shalën dhe Mulën. Tafil Shabani pyet nëse Mula është nga Kllodernica, të cilin e njohte. Ramiz Shabani e konfirmon se ishte ai. Pasi Shabanët kishin një nip të babait të tyre, Hoxha, në Kllodernicë, Tafil, Shabani thotë se do ta dërgoj Hoxhën për të kuptuar se ku ishte problemi dhe të bëjnë përmirësime me Mulën. Shabanët diskutojnë shkurtimisht përmirësimet për tu bërë dhe Tafil Shabani

thotë se nëse është ashtu siç e shpjegon Ramiz Shabani atëherë përmirësimet do të arrihen shpejt, aty për aty.

Ramiz Shabani e len vëllanë, elektrikistin dhe Hajdinin aty duke pirë lëng dhe shkon në shtëpi ku jetonte rreth 150 metra larg për të zhveshur uniformën. Ramiz Shabani len veturën në shtëpi e cila ishte duke u ndërtuar bashkë me çelësat e veturës dhe celularin e tij.

Kur Ramiz Shabani kthehet për të punuar në shtëpi ai nuk e sheh veturën e tij aty. Elektriciisti i thotë Ramiz Shabanit se dikush ka thirrur nga një numër i panjohur. Telefonuesi i kishte thënë se ata ishin te vendi i takimit dhe pyetën nëse Ramiz Shabani ishte rrugës duke ardhur. Elektriciisti i kishte thënë telefonuesit se Ramiz Shabani kishte shkuar pasi ai nuk e dinte se ai ishte ende aty.

Ramiz Shabani shkon te shtëpia e Tafil Shabanit ku takon gruan e Tafil Shabanit. Ai e pyet se ku ka shkuar Tafil Shabani, dhe ajo thotë se nuk e dinte. Ajo po ashtu i thotë se çiftja/pushka e gjuetisë nuk ishte në vendin e zakonshëm. Po ashtu është e mundur që Tafil Shabani dhe Hajdini kanë shkuar diku me veturën e Ramiz Shabanit.

Ramiz Shabani provon të thërras Tafil Shabanin por telefoni i tij ose ishte i fikur ose nuk kishte rrjet. Ramiz Shabani nuk provon të thërras Hajdinin apo Hoxhën pasi nuk kishte numër për ta. Ramiz Shabani provon të thërras Tafil Shabanin përsëri dhe kësaj radhe telefoni ra por askush nuk u përgjigj. Ramiz Shabani shkon te elektrikisti për të pyetur nëse Tafil Shabani dhe Hajdini kishin thënë se në cilin drejtim do të shkonin. Ata nuk kishin thënë, dhe elektrikisti as që i kishte parë ata duke u larguar.

Pastaj Ramiz Shabani shkon te shtëpia e axhës, shtëpia fqinjë. Gjatë kohës aty Osmani thërret Ramiz Shabanin dhe vërteton se Shabani ishte në shtëpi. Pastaj Osmani i thotë Ramiz Shabanit se gjërat kanë shkuar keq, se Tafil Shabani është vrarë, dhe se Shala i plagosur është dërguar te shtëpia e shëndetit në Drenas. Ramiz Shabani nuk kishte marrë ndonjë detaj të incidentit përmes telefonit.

Dëshmitari Burim Hajdini deklaroi se me 02 Shtator 2008 Hajdini e kishte vozitur babanë e tij në Drenas.

Ai thotë se pasi arrin në Drenas rastësisht takon Ramiz Shabanin. Ata nisen bashkë sepse Hajdini e kishte lënë veturën e babait të tij në Drenas dhe Ramiz Shabani donte të shkonte në shtëpi për disa punë elektrike. Hajdini dhe Ramiz Shabani udhëtojnë në veturën e njëjtë deri në Kozhicë ku Hajdini punonte për dajën e tij Tafil Shabanin, rreth 150 metra nga shtëpia e Ramiz Shabanit.

Gjatë vozitjes deri në Kozhicë, Hajdini dhe Ramiz Shabani hetuan Lekun por vazhduan në drejtim të shtëpisë së Ramiz Shabanit. Hajdini nuk kishte dëgjuar ndonjë bisedë në mes Lekut dhe Ramiz Shabanit.

Në ora 4.30 Tafil Shabani kërkon nga Hajdini ta dërgoj në fshatin Polac. Hajdini e vozit Tafil Shabanin në fshatin Polac në Vectrën e gjelbër të mbylltë të Ramiz Shabanit. Pas pyetjes se pse ai i kishte thënë Policisë kur është intervistuar me 3.9.2008 se ata kishin shkuar me Vectër të kaltër, Hajdini thotë se ai ishte i humbur në atë kohë dhe se nuk e dinte se çka ishte duke folur. Vectra nuk i përkiste Hajdinit. Ishte e regjistruar në emër të Ramiz Shabanit.

Atyre u mori në mes gjysmë ore dhe një orë që të shkojnë në Polac, pasi rruga ishte shteg i baltosur. Gjatë ngasjes Hajdini nuk kishte parë ndonjë gjë prapa në veturë dhe nuk e dinte se Tafil Shabani kishte armë. Tafil Shabani i thotë Hajdinit se ai donte të fliste rreth vëllait të tij, dhe se kishte një problem për të cilin duhej të bien dakord për diçka. Edhe pse jo i sigurt, është e mundur që Tafil Shabani i ka thënë Hajdinit që Ramiz Shabani është rrahur në punë. Hajdini nuk e din nëse Tafil Shabani ka iniciuar kontaktin me njerëzit që është dashur të takohet. Hajdini nuk e ka ditë kë ish in duke takuar.

Në fshatin Polac ata shkojnë te restoranti Elita-2. Kafeneja ishte e mbyllur. Tafil Shabani i thotë Hajdinit emrat e dy njerëzve që ish in duke i takuar; Njazi Mula dhe Rasim Shala. Hajdini e njihnte Mulën si fytyrë.

Ishte edhe një veturë tjetër në Restorant Elita-2, një Golf II i zi që i përkiste Mulës, dhe po ashtu edhe një Jetta e verdhë që ishte e parkuar pak më tutje. Tafil Shabani i thotë Hajdinit të parkohet në parking, me pjesën e përparme të veturës me fytyrë nga rruga.

Hajdini pandeh se ka parë gjashtë njerëz, katër nga të cilët ai i sheh qartë. Sipas Hajdinit, dy nga ta ish in në veturë pranë veturës së Hajdinit, dhe të tjerët ish in rreth 15 metra larg nga kafeneja dhe prapa murit të kafenesë. Hajdini ka parë armë tek tre nga këta njerëz. Ai nuk i njeh armët e zjarrit por ish in revole dhe dukeshin sikur TT në fotografitë që ai ka parë në dosjen e Prokurorit. Sipas mendimit të Hajdinit ai dhe Tafili ish in zënë në pritë.

Sipas Hajdinit ishte Shala personi i parë që doli nga vetura. Ai nxori pistoletën. Mula gjithashtu kishte pistoletën e tij të drejtuar nga Tafil Shabani. Hajdini del nga vetura që ai ngiste dhe kur ishte duke dalë ai dëgjon të shtëna. Pastaj Tafil Shabani shkon të merr pushkën nga bagazhi i veturës dhe i thotë Hajdinit “Largohu nip”. Në këtë moment Shala nuk ishte duke shtënë. Hajdini nuk kishte dëgjuar ndonjë bisedë në mes Tafil Shabanit dhe Mulës dhe/apo Shalës para se të fillojnë të shtënat.

Në pyetjen se kush shtiu i pari Hajdini përgjigjet se e shtëna e parë në të gjithë ngjarjen ka ardhur prej më poshtë. Pra nuk ish in asnjë nga njerëzit pranë veturës, Mula, Shala, Tafil Shabani apo Hajdini që filluan të shtënat. Nga njerëzit pranë veturave Tafil Shabani ishte i pari që shtiu. Tafil Shabani qëlloi Shalën në këmbë dhe pastaj Mula qëllon në drejtim të Tafil Shabanit dhe Shalës.

Hajdini po ashtu jep dy versione të përlëshjes rreth armës. Ai deklaron se Shala ishte qëlluar në këmbë dhe pastaj Shala e rrëmben pushkën e Tafil Shabanit. Ai po ashtu deklaron se Shala ka kërcyer në pushkën e Tafil Shabanit, ata përlëshen për pushkë dhe pastaj Shala qëllohet në këmbë. Tafil Shabani shtien dhe qëllon Shalën një herë. Hajdini

ka parë që Shala ka rrëmbyer pushkën e Tafil Shabanit me dy duar. Hajdini deklaroi se nuk e di çka ndodhi me pistoletën e Shalës të cilën e kishte nxjerrë më herët. Në kundërshtim me këtë ai po ashtu deklaroi se Tafil Shabani e rrëmben pistoletën e Shalës pasi Shala e rrëmben pushkën e Tafil Shabanit.

Hajdini pandeh që derisa Shala dhe Tafil Shabani ishin duke u përleshur, të tjerët që ishin aty afër shtinin në Tafil Shabanin. Në atë kohë Mula ishte duke shtënë sa mundej, nga mbi kapakun e veturës së tij, në drejtim të Tafil Shabanit. Ai nuk ishte larg, rreth 4 apo 5 metra më tutje. Hajdini nuk e kishte parë dikë të qëllon në ajër. Hajdini nuk është i sigurt kush e ka plagosur Shalën në gjoks. Shala nuk kishte shtënë në Tafil Shabanin. Sipas Hajdinit të tjerët më poshtë, të gjithë të katërtit, po ashtu qëlluan. Hajdini nuk e di çfarë lloj armësh të tjerët më poshtë kishin apo sa të shtëna kanë mundur të jenë nga të tjerët.

Shala ra në tokë dhe Tafil Shabani bie mbi Shalën. Pasi e sheh këtë Hajdini thotë që e ka "humbur veten" dhe ka ikur.

Dëshmitari Nazmi Leku deklaroi se ai më herët kishte punuar së bashku me ta dhe se ishte shok i ngushtë me Ramiz Shabanin, Shalën dhe Mulën. Sipas dijenisë së Lekut Ramiz Shabani dhe Mula kanë qenë në marrëdhënie të mira po ashtu, dhe se kurrë nuk kanë pasur ndonjë keqkuptim në mes tyre. Nazmi Leku nuk punon në TMK dy vitet e fundit.

Leku dhe Ramiz Shabani janë takuar me 2 Shtator 2008, gjatë orarit të punës. Megjithatë leku ishte në pushim ai ishte thirrur për një takim ceremonie në KFOR. Të gjithë ishin të renditur atë ditë. Aty të tjerët e kuptuan që Leku kishte pasur një festë syneti për djalin e tij në shtëpi. Ata thanë se do të më vizitojnë për ti uruar Lekut dhe se do ta lajmërojnë Lekun me telefon më përpara.

Leku nuk e kishte ditë lidhur me atë se Ramiz Shabani donte të shkonte më herët në shtëpi atë ditë, dhe se nuk e kishte kuptuar as më vonë.

Vetura e Lekut u prish rrugës duke u kthyer nga puna. Gjersa ishte duke e çmontuar veturën për të gjetur problemin, Ramiz Shabani dhe të tjerët u ndaluan pranë vendit të lekut. Pas orës 2 derisa Leku ishte duke punuar në veturën e tij, Ramiz Shabani dhe nipi i tij Hajdini u ndaluan aty. Ishin duke ngarë veturën e Ramiz Shabanit. Leku u ofroi pije por ata qëndruan vetëm pesë minuta duke folur lidhur me riatdhesimin e Hajdinit, dhe për kohën që ata do të vizitojnë Lekun. Ramiz Shabani nuk i tregoi Lekut rreth problemeve në punë.

Leku pasta e huazoi veturën e vëllait të tij, një Opel Vectra, që të shkoj të blej pjesët e ndërrimit. Duke udhëtuar në Skenderaj, Leku e sheh një veturë të Policisë para tij që e preu. Nga ky moment Leku nget pas tyre. Vetura e Policisë papritmas ndalohej dhe Lekut i duhet ti shmanget goditjes në ta. Ashtu siç u ndalua vetura e Policisë u largua nga rruga dhe u ndalua afër një hendeku por ende duke e bllokuar rrugën, kështu që Leku nuk kishte zgjedhje tjetër por vetëm të parkohet. Leku sheh Policinë duke vrapuar me armë, ai

frikohet dhe mendon se ata kishin problem me të. Leku parkon veturën me qëllim që të pyes ata pse ata ngisnin veturën në atë mënyrë obstrukcioniste dhe pse u ndaluan në mënyrën që u ndaluan pasi Leku gati e përplasi veturën e tij në ta.

Kur Leku arriti së pari në parking prapa Policisë, ai nuk dëgjoji ndonjë të shtënë. Ai në vendin e ngjarjes sheh vetëm Mulën, Shalën, Tafil Shabanin dhe Policinë. Ishin dy vetura në parking, Opel Vectra dhe një Golf 2. Dyert e veturave ishin të hapura plotësisht. Më vonë njerëzit erdhën nga të gjitha drejtimet; pesë apo gjashtë, ndoshta më shumë. Situata ishte disi kaotike sepse vetura tjera ndaloheshin, njerëzit dilnin nga vetura.

Kur Leku del nga vetura atij ia kap veshi kur Policia thotë: "Ndali të shtënat! Ndali të shtënat!" dhe pastaj "Shtrihuni". Leku sheh dy njerëz në tokë, njëri mbi tjetrin. Personi që ishte nën ishte i shtrirë në shpinën e tij. Ky ishte Shala, megjithëse Leku e njohu atë vetëm pasi afrohet të u ndihmoj atyre. Shala bërtiti, "Ndihmë! A ka dikush të më ndihmoj?" Ai vazhdoi të bërtiste me zë të lartë, kërkonte ndihmë. Personi që ishte sipër ishte me fytyrë nga poshtë. Ishte një pushkë aty dhe personi që ishte sipër mbante një revole, të tipit TT, në dorëz me dorën e tij të djathtë. Revolja ishte e zbrazur. Ishte e hapur. Kokat e tyre ishin në drejtim të njëjtë. Megjithatë ai deklaroi se personi sipër kishte të dy krahët rreth qafës së Shalës.

Më tutje nga aty ishte edhe një person, Mula ishte i shtrirë në bark në oborrin e restorantit duke mbajtur revolen në dorën e tij. Leku nuk kishte parë ndonjë të shtënë të vinte nga revolja. Mula ishte 10 deri 15 metra nga ku ishte leku. Mula dhe Leku nuk kanë folur në vendin e ngjarjes.

Oficerët e Policisë kërkonin ndihmë nga njerëzit aty. Ishin dy oficerë policie pranë Rasimit. Leku e njohu Shalën pasi iu afrua. Ai ndihmoi të vendos Shalën brenda në veturë.

Leku nuk dëgjoji ndonjë të shtënë kur ishte duke iu afruar Shalës.

Dëshmitari Fadil Xani deklaroi se personalisht nuk i njeh të dyshuarit Njazi Mulën dhe Rasim Shalën.

Në ditën e vrasjes në ora 5.10 pasdite Xani ishte duke udhëtuar në këmbë nga shtëpia e tij deri ku ai ishte duke punuar me makineri të rëndë prapa një kodre të madhe aty afër. Rrugës për te makineria e rëndë Xani e sheh një veturë Vectër në restorant. Vendi ku ndodhi incidenti ishte 15 metra nga shtëpia e tij dhe vendi i punës. Restoranti nuk mund të shihej nga ku ishte duke punuar sepse kishte një kodër në mes tyre. Restoranti ishte i mbyllur sepse nëna e Xanit kishte vdekur ditët e fundit.

Me të arritur në vend të punës, Xani dëgjon nga 4 deri 6 të shtëna, me pauza të konsiderueshme në mes të shtënave. Xani nuk ka pasur aftësi të përcaktoj llojin e armës së zjarrit.

Me të dëgjuar të shtënat Xani ndalon makinerinë dhe shkon në restorant. Ai së pari sheh vendin e ngjarjes nga rruga karshi restorantit. Ishin dy vetura të pranishme në vend të ngjarjes; një Golf ishte parkuar me fytyrë nga muri rrethues me tulla dhe Vectra që Xani e kishte parë më herët rrugës për te makineria e rëndë ishte po ashtu ende aty. Xani sheh dy njerëz të shtrirë në tokë – njëri mbi tjetrin. Ai ishte 20-30 metra nga ta. Aty ishte një armë me tytë të gjatë shumë afër njerëzve të shtrirë në tokë. Xani nuk është i sigurt nëse ka parë ndonjë armë tjetër mbi dy trupat e shtrirë. Xani nuk ishte më shumë se 5 deri 10 sekonda aty para se të arrij policia. Policia nuk e lejon askënd të afrohet.

Xani po ashtu ka parë një person duke mbajtur një armë dhe duke ecur së prapthi. Xanit nuk i kujtohej më çfarë lloj arme mbante personi që ecte së prapthi. Kur atij i lexohet deklarata e dhënë në polici “E kam parë një person me një armë të një kalibri të vogël, të shkurtër, e kam hetuar atë derisa ai ishte duke ecur së prapthi në drejtim të Drenasit dhe duke drejtuar armën në drejtim ku kishte ndodhur incidenti” ai konfirmon që kjo është e saktë. Xani nuk e kishte parë këtë person të shtien. Në shqyrtimi kryesor Xani e identifikon Mulën sikur personin që ishte duke ecur së prapthi.

Xani gjithashtu ka parë një person duke vrapuar në drejtim të shtëpisë së tij. Xani nuk e di nëse ky person ka pasur armë.

Xani ka dëshmuar që policia mund të ketë ndaluar vetura duke kaluar pranë për të kërkuar ndihmë, megjithëse nuk është i sigurt për këtë fakt. Shoferi i veturës dhe policia ndihmuan të parët për të vendosur personat e palgosur në veturë. Xani nuk kishte qasje tek ai apo nuk e kishte prekur atë. Xani është afruar për të ndihmuar vetëm kur i është kërkuar nga policia të bëjë këtë. Policia kërkon nga Xani që të ndihmojë të largoj personin e dytë dhe ta vendos atë brenda në veturë, dhe Xani e bën këtë. Xani e vlerëson vet që ky person mund të jetë i vdekur sepse ai nuk lëvizte dhe ishte disi i verdhë dhe i rëndë kur ata e ngritën. Xani nuk kishte parë asgjë në duart e tij apo dikë të largoj mjete nga duart e tij.

2 apo 3 ditë më vonë Xani informon policinë se dukej sikur të shtënat ishin qëlluar në drejtim të restorantit pasi kishte vrime të plumbit në derë dhe në muri. Nuk ka dëshmi për të lidhur këto vrime të plumbave me incidentin e 2 Shtatorit 2008

Dëshmitari Shemsedin Geci deklaroi se me 2.9.2008 Geci dhe kolegu i tij Shkelzen Selimi ishin në detyrë në patrullë. Ishin duke vozitur në drejtim të Skenderajt. Geci nuk kishte vërejtur nëse dikush ishte duke u shkuar pas atyre. Ata nuk kishin dëgjuar ndonjë të shtëne por vëmendja e tyre ishte tërhequr nga një djalë i ri duke vrapuar përgjatë rrugës, pastaj kalon rrugën dhe vazhdon duke vrapuar në drejtim të Skenderajt. Më vonë Geci mëson se ai ishte nipi i viktimës. Geci dhe Selimi shkojnë në drejtim të tij por nuk e ndalojnë sepse ata arrijnë te vendi i ngjarjes.

Kur ata iu afruan parkingut të Restorantit Elita-2 aty ishin dy vetura. Njëra nga to ishte Opel Vectra. Distanca në mes të dy veturave ishte një deri dy metra. Geci nuk kishte hetuar ndonjë veturë tjetër.

Geci sheh dy persona të shtrirë në tokë njëri mbi tjetrin. Ata i kishin kokat në drejtim të murit rrethues dhe këmbët në drejtim të rrugës. Rreth ½ metër nga ta, për afërsisht te barku, ishte një revole e tipit TT dhe një pushkë me tytë të gjatë. Armët ishin afër njëra tjetrës, në anën e djathtë të personit që ishte i shtrirë poshtë.

Pranë restorantit Geci sheh po ashtu një person duke mbajtur një revole me tytë në drejtim nga lartë poshtë, e drejtuar nga këta dy personat në tokë por jo duke shtënë. Geci nuk mund të përcaktoj qartë nëse revolja ishte e drejtuar në këta dy persona në tokë.

Geci nuk ka parë persona tjerë në parking.

Geci ka njohur të dy Mulën dhe Shalën nga më herët por nuk i identifikon ata kur ai arrin në vend të ngjarjes. Vetëm më vonë ai e kupton kush ishin ata.

Pasi Geci dhe Selimi ndaluan afër vendit të ngjarjes personi që ishte akoma duke qëndruar në këmbë dhe duke mbajtur armën ishte para tyre dhe dy të shtrirët në tokë ishin pranë veturës së policisë, afër Gecit. Geci del nga vetura me armën e tij në dorë dhe i thotë personit që kishte revolen në dorë, që më vonë Geci e kupton se ishte Njazi Mula, ta lëshoj revolen. Mula bën atë që i thuhet. Kolegu i Gecit Selimi prangos Mulën. Mula kërkon ndihmë.

Personi i shtrirë në tokë, i poshtmi, ishte me fytyrë nga lart dhe ai kishte një plagë serioze në këmbën e tij. Më vonë Geci e kupton që është Rasim Shala. Shala bërtet dhe thotë se këmba e tij është prerë dhe kërkon ndihmë. Geci nuk ka parë ndonjë armë në Shalën. Shala nuk i tregon Gecit se çka ka ndodhur, dhe Geci nuk e pyet.

Personi sipër ishte me fytyrë nga toka. Personi sipër ishte goxha i rëndë dhe Shala nuk mund ta lëvizte atë. Geci e rrëmben atë dhe kërkon asistencë nga një person që ishte aty. Personi që ishte sipër nuk bërtiste dhe nuk ankohej për shkak që lëvizte kështu që Geci injoron të gjitha sa i përket gjendjes së tij. Geci sheh gjak por nuk kishte parë lëndimet në të. Ky mund të jetë i njëjti gjak i shënuar me numër 7[gjak] në skicën që ka bërë policia të vendit të ngjarjes. Geci nuk ka mundur të tregoj se si ishin të vendosura krahët e të dy të shtrirëve në tokë.

Një veturë arrin në parking derisa Geci ishte duke u kujdesur për personat në tokë dhe Geci dhe kolegu i tij ndaluan dy vetura civile. Geci kërkon nga tre persona të ndihmojnë por nuk mban mend kush ishin ata. Për arsye se armët ishin ende në tokë njëri nga oficerët e policisë vazhdon ti ruaj ato.

Geci ka vënë të plagosurit në automjetet për ti derguar për të marrë ndihmën e parë. Pas kësaj Geci hoqi armët në mënyrë që askush tjetër te mos kishte qasje në to. Pushka kishte një plumb në fole dhe arma e dores ishte boshatisur, foleja e hapur. Geci i futi armët në një thes dhe kerkoj per perforcime - per tju ardhur atyre ne ndihme. Geci e siguroi vendin e ngjarjes me një shirit dhe nderkaq forcat perforcuese arriten. Geci u largua dhe oficerët e tjerë e zevendesuan ne vendin e ngjarjes. Geci nuk ishte i pranishëm në inspektimin e gezhojave në vendin e ngjarjes pasi njesia per inspektimin e vendit te ngjarrjes do të merrej me kete. Menjëherë pasi ata arrestuan personin ata e kishin parë duke ikur.

Dëshmitari Shkelzen Selimi ka deklaruar se ai ishte në detyrë më 02 shtator 2008 me një koleg te tij, Shemsedin Geci, i cili po ngiste makinën. Ata panë një njeri qe vraponte perpara automjetit të tyre nga drejtimi i Morinës në drejtim të Skenderajt diku 70-80 metra nga Restorant Elita-2. Ky njeri ishte Burim Hajdini .

Pasi arritën në afërsi të Restorant Elita-2 ata pane dy njerëz të shtrirë në tokë mbi njëritjetrin dhe e kishin ndaluar automjetin.

Pastaj, gati në fund të restorantit, ata panë një njeri të tretë me një armë duke treguar në drejtim të njerëzve të shtrirë në tokë. Selimi nuk ka parë askënd tjetër në parkingun e makinave. Selimi nuk ka dëgjuar asnjë te shtene, ndërsa ai dhe Geci ishin në vendngjarje.

Në parkingun e makinave ishin dy automjete, një blu Opel Vectra dhe ndoshta një Golf 2. Golf ishte parkuar siç duhet. Selimi nuk mban mend se si ishte e parkuar Vectra. Përpara Golfit, ishte një mur. Distanca në mes dy automjeteve nuk ishte e madhe, jo më shumë se 2-3 metra. Distanca në mes dy njerëzve të shtrirë në tokë dhe automjeteteve ishte rreth 2 deri në 4 metra.

Kur Selimi doli nga automjeti ai dëgjoji dikë duke i kërkuar ndihmë: "e kam këmben te lenduar nga bleta". Njeriu i cili po kerkonte për ndihmë ishte poshte, I shtrirë në shpinë. Në fillim Selimi nuk ju afrua pranë dy njerëzve të shtrirë në tokë, se ai ishte i përqëndruar të njeriu me armë. Më vonë Selimi e kuptoi që arma ishte një revole TT dhe e njohu personin që e mbante atë, Njazi Mulën. Selimi dhe Geci I tërhoqën armët e tyre dhe I kërkuan Mulës për të lëshuar armën e tij. Mula menjëherë bashkëpunoi me urdhërat e policisë dhe Selimi shkoi për ti vënë prangat Mulës. Mula nuk ka kërkuar ndihmë, por kur ata e arrestuan, ai u kërkoi atyre që ti ofrojnë siguri atij duke thënë: "Më merrni se ata janë duke ardhur qe të më vrasin mua". Pasi Selimi I kishte vënë prangat Mulës ai nuk ja ndante sytë Mulës pasi ai që ishte I shtrirë thoshte: "Ata do të më vrasin".

Selimi nuk mban mend, nëse ai pa ndonjë shenje plagosje në personin siper personit tjetër ne tokë. Ka patur armë pranë dy personave të shtrirë në tokë, por Selimi nuk mban mend, ku pikërisht, pasi Geci i kishte hequr armët. Pas Geci i mblodhi armët Selimi pa që ato ishin një TT dhe një pushke me karikator me dhjetë plumba. Geci gjithashtu mori edhe pistoletën që Mula kishte lëshuar dhe e vuri këtë me dy armët të tjera.

Pasi kolegët e Selimit e morën të dyshuarin dhe armët, ai dhe Geci iu afruan të dy personave të shtrirë në tokë. Geci e futi njërin prej tyre në automjet civil dhe i kërkoi njerëzve aty për ta çuar viktimën në spital. Selimi nuk foli me shoferin e automjetit.

Shkelzen Selimi nuk e di numrin e gëzhjave të plumbave të gjetura në vendin e krimit pasi kjo ishte detyra e inspektoreve të vendit të ngjarjes.

I pandehuri Njazi Mula ka deklaruar se ai dhe Shala janë miq, siç janë të gjithë 55 anëtarët e Brigadës. Mula dhe Shala ishin së bashku në luftë, dhe pas luftës në TMK. Ata shoqërohen së bashku, por ata nuk kanë folur për armë kurrë. Përveç në kohën e luftës Mula nuk ka parë që Shala të ketë armë kështu Mula nuk e di nëse Shala mban armë.

Kur Mula nuk është i veshur me uniformën e tij ai gjithmonë mban pistoletë në mes për arsye sigurie, sepse ai ka takime apo mbledhje në mesnatë dhe më vonë. Atij nuk është dashur për ta përdorur armën. Arma ishte e vëllait të tij që u vra gjatë luftës. Mula nuk e di nëse Shala e dinte që ai kishte armë pasi ai nuk ja kishte treguar ose përdorur atë.

Sa i përket mosmarrëveshjes mbi orarin e punës, Mula dëshmoi se Shabani asnjehere nuk i kërkoi Mules leje për t'u larguar më heret, dhe mohon ti kete thënë ndonjehere Shales se Shabani nuk mund të largohet më heret. Përkundrazi, Mula dëshmoi se ai i kishte dhënë Shabanit një herë leje për t'u larguar më heret, përmes Shales.

Më 2 shtator Mula shkoi në zyrën e komandantit të marrë detyrat e tij të ditës dhe Osmani urdhëroi Mulen, i cili në atë kohë ishte shef i Komisionit Disiplinor në brigadë, për të marrë deklarata nga tre anëtarë, të cilët kanë munguar tre ditë me pare. Një prej tyre ishte Ramiz Shabani.

Mula shkoi në zyrën e Shalës për shkak të urdhërit të dhënë nga Osmani. Ramiz Shabani ishte aty me Shalën dhe subjekti i bisedës së tyre ishte mungesa e Ramiz Shabanit. Mula pyeti se çfarë kishte ndodhur për shkak se Ramiz Shabani nuk ishte larguar me pare pa leje. Ramiz Shabani u përgjigj se djali i tij kishte qenë i sëmurë dhe gruaja e tij e kishte thirrur atë. Mula pyeti pse Ramiz Shabani nuk ju kishte thënë atyre për djalin e tij të sëmurë pasi Mula do ta kishte çuar atë në shtëpi vete me automjetin e tij. Mula e kishte bërë këtë më parë. Ramiz Shabani u përgjigj se ai nuk u perpoq për të kërkuar leje prej askujt, dhe se ai largohej sa herë që ai donte. Meqenese Ramiz Shabani ishte duke folur me zë të lartë dhe në një mënyrë që e bëri të pamundur komunikimin me të Mula i kërkoi Ramiz Shabanit të largohej nga zyra dhe informoi komandantin. Mula dëshmoi se zëri i Mules mund të kete qene i ngritur disi kur ai i tha Ramiz Shabani të largohet, por nuk kishte asnjë arsye që ai të ikte me vrap. Takimi u zhvillua në një mënyrë zyrtare. Mula nuk i ka rene me shuplake ne fytyre Ramiz Shabanit ne asnje moment ose ti kete mohuar Ramiz Shabanit lejen për të shkuar në shtëpi. Rasim Shala nuk ishte kërcënuar me armë. Mula nuk e kishte pistoletën e tij TT, te zezë me vete, por në fakt ajo ishte në makinën e tij.

Më pas Mula mësoi se Ramiz Shabani kishte shkuar për të parë Osmanin edhe pse ai nuk kishte të drejtë ta bënte këtë. Sipas rregullave të brendshme Ramiz Shabani duhet të kishte shkuar te Osmani me Shalen. Nga sa di Mula, Ramiz Shabani shkoi për të kërkuar leje për t'u larguar dhe i tha Osmanit që kishte plasur nje fjalosje në mes Mules dhe Shales, nga njëra anë dhe Ramiz Shabanit në anën tjetër dhe se ai ishte kërcënuar nga ata. Megjithatë, sipas Mules, nuk ka pasur zemërim për këtë çështje dhe kjo nuk ishte personale, por zyrtare.

Më 2 shtator Tafil Shabani i telefonoi Shales duke përdorur telefonin e Ramiz Shabanit, kur ata dolën nga puna. Mula nuk e di se për çfarë biseduan Shala dhe Tafil Shabani, porveç se Tafil Shabani kishte kërkuar që të fliste me Mulen. Shala i dorëzoi telefonin Mules dhe ai foli me Tafil Shabanin. Mula së pari e pyeti se me ke po fliste. Tafil Shabani i tha Mules se ai ishte vëllai i madh i Ramiz Shabanit. Tafil Shabani pyeti nëse ata mund të takohen në qendër të Skenderajt për t'u ulur dhe flasin rreth disa fjalëve zyrtare që Mula kishte pasur me Ramiz Shabanin. Tafil Shabani gjithashtu donte të fliste për problemet e Ramiz Shabanit si dhe arsyeja për mungesat e tij, si dhe mundësinë për ti dhënë leje Ramiz Shabanit pasi ai kishte punë në shtëpinë e tij. Pra, sa i përket takimit me Tafil Shabani, ai supozohej të ishte miqësor.

Miqesisht Mula i tregoi Tafil Shabanit që Mula dhe Shala mund të vinin në shtëpinë e Shabanit për të diskutuar këtë çështje. Tafil Shabani u përgjigj; "Jo. Ne duhet të takohemi në Skenderaj." Ata vendosën kohën e takimit për 18,00 në Skenderaj. Mula ra dakord të takohet me Tafil Shabani, sepse të gjitha familjet e Brigadës kishte marrëdhënie të mira dhe ai u takua me të gjithë anëtarët e familjeve të personelit të tyre. Mula ka qenë një herë në shtëpinë e Shabanit për të shprehur ngushëllimet e tij, por Mules nuk i kujtohet nëse Tafil Shabani ishte aty. Nëse jo atëherë Mula nuk e kishte takuar Tafil Shabanin më parë. Pra ajo bisede telefonike ishte hera e parë që Mula foli me Tafil Shabanin.

Mula dhe Shala ishin të veshur me uniforma. Meqenëse atyre nuk ju lejohej të dilnin nëpër kafene me uniforma Mula e çoi Shalen në shtëpinë e tij me makine dhe pastaj shkoi në shtëpi. Ai kishte drekë me familjen e tij. Rreth 4:30 Tafil Shabani përsëri i telefonoi Mules dhe e pyeti nëse Mula mund të shkonte në 5:00 në vend të orës 6:00 pasi Tafil Shabani kishte disa punë për të bërë pas punës. Tafil Shabani kërkoi të takohet në fshatin Polac tek pemët, ku është një pompe benxine. Mula ra dakord dhe e informoi Shalen gjithashtu pasi që ata kishin rënë dakord të shkojnë së bashku. Mula e mori Shalën me makinën e tij dhe ata u nisën në drejtim të Skenderajt. Automjeti i Mules ishte një Golf Zi 2 dhe në të Mula bëri një vend tek kutia e shpejtësive (kutia e ndërrimit të marsheve) për të mbajtur pistoletën e tij TT. Gjatë udhëtimit Mula dhe Shala kanë diskutuar se për çfarë të blenin për fëmijët e tyre pasi atë ditë ata kishin marrë rrogat.

Rrugës për të takuar Tafil Shabanin, Mula ka marrë telefonata nga ai. Tafil Shabani i ka thirrur dy herë për të pyetur ata se ku ishin dhe se sa kohë do t'ju duhej. Mula i tha atij se ku ishim - në fshatin e Kopiliq, ose aty rrotull. Shala gjithashtu telefonoi Tafil Shabanin, kur ata ishin në Llaushe për të pyetur nëse Ramiz Shabani ishte me të, por dikush tjetër iu përgjigj në telefon. Ky person i tha Shales se ata kishin ikur, duke përfshirë edhe Ramiz Shabanin.

Tafil Shabani telefonoi Mula në telefonin e tij përsëri duke e pyetur nëse Shala ishte me të. Mula u pergjigj "Po" dhe e pyeti se ku do të takohen ata. Tafil Shabani u pergjigj se ai ishte te pompa e benzines. Mula i tha atij të shkonte ne Restorant Elita-2 dhe te porosiste pasi ata do të arrinin aty për disa minuta. Tafil Shabani premtoi se do të priste për ta dhe Mula po priste për t'u takuar me Tafil Shabanin dhe Ramiz Shabanin. Nga momenti i telefonates se fundit teTafil Shabanit, Mules ju deshën pesë deri në dhjetë minuta për të arritur në Restorantin Elita-2.

Kur Mula dhe Shala arriten në Restorant Elita-2 Vectra e Ramiz Shabanit ishte atje. Mula po parkonte shumë afër Vectres, diku nje meter e gjysëm. Vectra kishte përballë rrugën dhe Golfi i Mulës kishte përballë murin. Golf ishte më pranë murit ndersa Vectra ishte më afër rrugës. Ka pasur dy persona në këmbë jashtë automjetit dhe pranë tij - një në anën e shoferit dhe një në anën e pasagjerit. Mula nuk i njohu ata. Ramiz Shabani nuk ishte aty.

Ndërsa Mula dhe Shala po parkonin në parkingun e makinave, dhe ndersa Shala ishte duke dalë nga makina dhe Mula po fikte motorin, Tafil Shabani hapi derën e përparme të pasagjerëve dhe nga poshtë karriges se tij nxorri nje pushkë me tytë të gjatë. Shala ishte me fytyre nga rruga. Tafil Shabani kaloi prapa automjetit te Mules. Shala ishte ende afër deres se makines dhe ngriti duart lart. Shala ka thënë: "Për hir të Zotit! Ne nuk rame dakord për t'u takuar për këtë, por të pirë kafe ". Tafil Shabani e drejtoi pushkën në gjoksin e Shalës. Mula doli nga makina nga ana e shoferit, e u kthye për të parë se çfarë po ndodhte dhe qëndroi aty, afër me derën. Mula mendoi se Tafil Shabani do ti qellonte me arme Mula dhe Shalen dhe ti vriste ata. Sipas mendimit te Mules, ata ishin tradhtuar dhe zene ne pritë dhe ishte i qartë qëllimi i Tafil Shabanit për të takuar Mula dhe Shalen e për të vrarë ata të dy.

Shala u hodh dhe per fat mundi ti rrëmbeje pushkën Tafil Shabanit, nga tyta dhe e uli atë. Tafil Shabani kurrë nuk e lëshoj pushkën. Pastaj arma i ra dhe goditi Shalen në këmbë. Kjo ishte e shtëna e parë qe Mula dëgjoi. Shala bertiti "O Zot". Pasi ka plagosur Shalen Tafil Shabani ja drejtoi armën Mules, i cili ishte ndoshta 70-10 metra larg, por Shala e kapi perseri armën e Tafil Shabanit përsëri dhe e uli poshtë. Ai nuk po e leshonte pushkën, edhe pse i plagosur. Mula u frikësua për shkak se ai kishte parë vetëm Tafil Shabani te shtine mbi Shalen dhe mendoi se nëse ai qëllonte në ajër do të ndalte Tafil Shabani të shtinnte në atë. Ende te dera e automjetit të tij Mula nxorri nga mesi armen e tij dhe qëlloi 4 herë në ajër. Tafil Shabani ishte ende duke u mbajtur ne pushkë me dorën e djathtë dhe Shala ishte ende duke mbajtur tyten e armes kur Tafil Shabani tërhoqi armë me dorën e majtë dhe ka shtënë drejt Mules të paktën një herë, ndoshta dy herë. Kur Shabani ka shtënë drejt Mules, Mula kishte pistoletën- TT në dorën e djathtë. Ai po e mbante te ulur, në anash këmbës se tij, dhe kjo kishte mbetur e hapur. Ajo mund të ketë qenë pa plumba ose e bllokuar. Mula zakonisht mban pistoletë me shtatë plumba.

Mula ka rënë në tokë në mënyrë qe ai te mund të ikte dhe nuk ishte në gjendje për të parë se çfarë po ndodhte midis Tafil Shabanit dhe Shales. Armë që Tafil Shabani tërhoqi ishte e zezë, por Mula nuk mund të shihte llojin e armës. Sipas mendimit te Mules Tafil

Shabani kishte shtënë mbi Mula për ta vrarë atë. Mula u përpoq që të gjej një vend për të shkuar që të mos goditej. Pastaj ai u kthye me shpine nga Tafil Shabani dhe dëgjoi një të shtënë.

Në deklaratën e tij në polici, datë 2.9.2008 dëshmitari Kasim Xani deklaroi se derisa ai ishte duke punuar përpara Restorantit Elita-2 pas një toke kodrinore ka dëgjuar të shtëna. Ai shkoi në kodrën nga ku restoranti mund të shihet dhe pa një person në fund të parkingut të restorantit me një revolver në dorë. Ky person po shtinte me armë në drejtim të parkingut të vendosur përpara restorantit. Në atë moment patrulla e policisë arriti.

D. Vlerësimi i provave të paraqitura

1. Konstatimet faktike

Me provat e paraqitura gjatë rrjedhës së shqyrtimit gjyqësor, Gjykata e konsideron si të provuara faktet e mëposhtme:

Është e padiskutueshëm që dy ose tre ditë para 2 shtatorit 2008 Mula, Shala dhe Ramiz Shabani u takuan në zyrën e Shalës, për të diskutuar mungesat e Ramiz Shabanit. Ky fakt mbështetet nga deklaratat e të dyve Ramiz Shabanit dhe Mules. Mula dhe Shala të dy thonë se Ramiz Shabani tha se djali i tij kishte qenë i sëmurë dhe gruaja e tij e kishte thirrur atë. Për më tepër deklaratat e tyre pajtohen në atë që Mula kishte ngritur zerin në fund të takimit. Gjykata më tej konstaton se takimi nuk u krye thjesht në mënyrë zyrtare. Aty qartë kishte një mosmarrëveshje pune mes Ramiz Shabanit, Mules dhe Shales dhe disa fjalë të ashpra janë shkëmbyer mes tyre, ndoshta duke rezultuar në një sulm fizik mbi Ramiz Shabani. Ky përfundim mbështetet edhe nga fakti i padiskutueshëm se pas takimit Ramiz Shabani shkoi për të folur me Komandant Osmanin dhe pohoi se Mula dhe Shala e kishin kërcënuar atë. Më tej Gjykata konstaton se Mula dhe Shala ishin në një pozitë me të lartë sesa Shabani.

Me 2 Shtator 2008 vella I Ramiz Shabanit, Tafil Shabani ne njeran ane e Mula dhe Shala nga ana tjetere rane dakord te takohen dhe per te diskutuar per kete mosmarreveshje ne lidhje me mungesat e Ramiz Shabanit . Ky fakt mbeshtetet nga deklarata e Ramiz Shabanit i cili ka deklaruar se ai i kishte thënë Tafil Shabanit se ai kishte probleme me Shalën dhe Mula dhe Tafil Shabani tha se ai do të dërgojë Hoxhen për të gjetur se çfarë ishte kjo çështje mbi të gjitha dhe për tu shlyer me Mula. Kur Ramiz Shabani u kthye pasi kishte nderruar uniformën e tij të punës nje elektrikist qe punonte në shtëpinë e Ramiz Shabanit, i tha atij se dikush kishte thirrur nga një numër i panjohur dhe tha se ata ishin në vendin e takimit. Ky fakt mbështetet gjithashtu nga deklarata e Hajdinit i cili ka deklaruar se Tafil Shabani I kërkoi Hajdinit për ta marrë atë në fshatin Polac. Ndërsa ata ishin duke vozitur makinën Tafil Shabani I tha Hajdinit se ai do të fliste për vëllain e tij, se ka pasur një problem dhe se ata duhet të binin dakord per diçka. Ndoshta Tafil Shabani

I tha Hajdinit se Ramiz Shabani ishte rrahur në punë. Ky fakt mbështetet gjithashtu nga deklarata e Mules i cili deklaroi se kur Mula dhe Shala lane punën e Mula foli në telefon me Tafil Shabanin dhe Tafil Shabani e pyeti nëse ata mund të takohen në qendër të Skenderajt për t'u ulur dhe diskutuar rreth disa fjalëve te natyres zyrtare qe Mula kishte pasur me Ramiz Shabanin. Mula ra dakord të takohet me Tafil Shabanin, sepse ai kishte mardhenie te mira me të gjitha familjet e Brigadës dhe ai ishte takuar me të gjithë anëtarët e familjeve te personelit të tyre. Gjykata konstaton se Tafil Shabani, Mula dhe Shala ranë dakord të takohen në Restaurant Elita-2 për të diskutuar mosmarrëveshjen.

Me 2 Shtator 2008 Tafil Shabani dhe Burim Hajdini ishin te paret qe arriten ne parkingun e Restorant Elita-2. Ky fakt është i përkrahur nga deklaratat e Fadil Xanit, i cili deklaroi se si ai ishte duke udhëtuar në këmbë nga shtëpia e tij për te, ku ai ka punuar me makineri të rënda prapa kodrës së madhe kur ai pa një automjet Vectra në restorant. Deklarata e Fadil Xanit është mbështetur edhe nga fakti se Vectra ishte parkuar përballë rrugës, e cila tregon se shoferi kishte pasur kohë të parkonte automjetin. Është konstatuar në mënyrë të qartë nga Gjykata që Tafil Shabani dhe Burim Hajdini ishin të parë të mbërritën dhe parkuan përballë rrugës, dhe që Mula dhe Shala arriten te dytet dhe parkuan përballë murit me pjesën e prapme të makinës së tyre të përballë rrugës.

Më 2 shtator 2008 Njazi Mula ishte në zotërim të një pistoletë TT dhe ai ka shtene me pistoletën e tij, ndërsa ishte në parkun e makinave. Këto fakte nuk janë të diskutueshme, por te konfirmuara nga vetë Mula. Kjo deklaratë është mbështetur nga raporti I egzaminimit penal, I padatur nga Lutfi Rraci që thekson se shtatë gezhoja të tipit te pistoletës TT si ajo qe është përdorur nga Mula (7,62 X 25 mm), jane gjetur në vendin e ngjarjes dhe se katër nga këto shtatë gezhoja pershtaten ne aspektin forensik qe te jene shtene nga pistoleta me numrin serik 863307 te cilen Mula e pranoi qe ishte e tija. Gjykata më tej konstaton se të tre gëzhojat e tjera nuk jane përputhur me asnjë nga armët e tjera te gjenduar ne vendin e ngjarjes. Te vetmet gezhoja të gjetura në vendin e ngjarjes ishin te llojit që përdoren në pushkë të gjatë të identifikuara qe ti perkasin Tafil Shabanit (7,62 X 39 mm), por sidoqofte ne keto gezhoja nuk jane kryer veprimet forensike për të përcaktuar nëse do të ishin shtene nga pushka e Tafil Shabanit. Hetuesit nuk kane gjetur gezhoja të tjera në vendin e ngjarjes.

Është e padiskutueshme që Tafil Shabani u vra dhe se Rasim Shala u plagos në këmbën e tij dhe ne anen e djathtë të gjoksit pranë qafës gjatë shkëmbimit të të shtënave me armë në parkingun e makinave te Restorant Elita-2

2. Provat lidhur me vrasjen nga Njazi Mula

Siç u tha më lart, Njazi Mula ka pranuar që të kete shtene katër herë në ajër, pasi Tafil Shabani kishte shtene në këmbën e Shales dhe ndersa Tafil Shabani dhe Shala ishin duke

luftuar për pushkën.

Mula ka deklaruar se Hajdini dhe Tafil Shabani ishin tashmë në parkingun e makinave të Restaurant Elita-2 kur ai dhe Shala arritën atje. Kjo deklaratë mbështetet nga deklaratat e Fadil Xanit i cili deklaroi se kur ai ishte duke udhëtuar në këmbë nga shtëpia e tij për në vendin ku ai ka punuar ai pa një automjet Vectra në restorant gjatë rrugës për të makineritë e rënda. Kjo është mbështetur në mënyrë indirekte nga fotografitë e marra nga policia që heton rastin që tregon se automjeti Vectra ka hyre me indjetro apo duke ecur mbrapsh në parkingun e makinave dhe e parkuar me pjesen e saj të pasme në drejtim të gardhit. Ky fakt mbështet konstatimin e gjykatës se Tafil Shabani dhe Hajdini nuk ishin nën ndonjë kërcënim në kohën kur ata arritën në vendin e të shtenave, pasi nuk ka gjasa që dikush do të parkonte në këtë mënyrë, nëse po kërcënohej. Më tej, Gjykata nuk beson pretendimin e Mules se Tafil Shabani menjëherë paska nxjerre pushkën nga një vend poshte uleses së automjetit të tij. Para së gjithash kjo është plotësisht në kundërshtim me deklaratën e Hajdinit se ai nuk e kishte parë asnjë armë të tillë në makinë, por ndoshta më e rëndësishmja është që është parë si praktikisht e pamundur për një armë e madhësisë së pushkës së Tafil Shabanit që të mund të ruhet në sediljen e pasme të automjetit dhe e nxjerre në mënyrë të arsyeshme. Dëshmi se ajo ishte në bagazh siç pohohet nga Hajdini është më e besueshme dhe besohet nga gjykata.

Sipas raportit të egzaminimit penal nga Lutfi Rraci kater nga gezhojat e gjetura në vendin e ngjarjes janë pershtatur pistoletes së Mules. Gezhojat e tjera të vetme në vendin e ngjarjes, tre në numër, që nuk përkohjnë me asnjë nga armët e gjetura në skenën e të shtenave. Tre nga keto katër gezhoja që perkuan me pistoletë të Mules u gjetën në afërsi të shkallëve të restorantit, pranë makinës së Mules. Provat forensike mbështesin deklaratën e Hajdinit që ka deklaruar se Mula kishte shtënë sa më shumë që të mundte, nga sipër pjesës së perparme të makines, kundrejt Tafil Shabani.

Gjykata konstaton deklaratën e Mules lidhur me të shtënëat e tij në ajër të pabesueshme për arsyet e mëposhtme: së pari, Mula ka deklaruar se menjëherë pasi që u qëlluan nga Tafil Shabani po e mbante pistoletën e tij TT të ulur poshtë anash këmbës së tij dhe pastaj ai ra në toke. Gjykata konstaton, kete si të pabesueshme që pasi është shtënë në të, ndërsa ai mbante pistoletën në dorën e tij, do të mbante armën anash dhe pastaj bie në tokë, së dyti, Hajdini i cili ishte një dëshmitar okular në ngjarje në mënyrë të qartë ka parë se ishte Mula ai që ka shtënë në drejtimin e Tafil Shabanit dhe Shales; së treti, dëshmitari Fadil Xani pa Mulen duke ecur prapa në afërsi të restorantit që mbante një armë drejtuar nga Tafil Shabani dhe Shala të cilët ishin në terren. Kjo është në kundërshtim me atë që Mula mbante armën e tij poshtë, ndërsa ndaj atij po shtihej dhe në një moment më vonë atë (armën) e drejton në dy njerëz të shtrirë në tokë e pashprese; së katërti, dëshmitari Kasim Xani deklaroi se ai e pa një person në fund të parkingut të restorantit me një revolver në dorë duke shtënë në drejtimin e parkingun që ndodhej përpara restorantit. Në fundi në baze të raportit të egzaminimit penal nga Lutfi Rraci asnjë gezhoje nuk ka perkuar me pistoletën me numer serie C 57818 sipas pretendimit të Mules të përdorur nga Tafil Shabani. Prandaj provat mjeko-ligjore nuk e mbështetin deklaratën e Mules për aq sa ai deklaroi se Tafil Shabani tërhoqi armën me dorën e majtë dhe ka shtënë drejt Mules të

paktën një herë, ndoshta dy herë. Për më tepër, kjo tregon se nuk Mula u qëllua përpara se ai te shtinte me armen e tij.

Sipas Raportit hetimor date 3.9.2008 policia ka gjetur 11 gezhoja te pushkes se gjate te kalibrit dhe te njejta si ato qe mund te ishin perdorur nga arma e Tafil Shabanit ne vendin e ngjarjes. Nga fotografia me numer 8 bashkangjitur në dosjen e identifikimit te mjekësisë ligjore # 08-094 mund të shihet se këto 11 gezhoja të ishin të padëmtuara. Sipas raportit të lartpërmendur është gjetur një fishek bosh I të njejtit kalibër. Ky fishek nuk është testuar, por u gjet pranë pushkë dhe është i kalibrit të njëjtë si fishekët të tjera te paperdorur.

Nuk ka patur gezhoja per te mbeshtetur deklaraten e Hajdinit, qe aty kishte persona te tjere me tutje qe kane qelluar te shtenen e pare e po ashtu kjo nuk eshte mbeshtetur nga deklaratat e askujt ne vendin e ngjarjes. Azem Hajdini eshte I gabuar qarte ketu, ose, në rrezikun e momentit, i hutuar - sipas fjalëve të tij "humbur" – sa I perket ekzistimit te këtyre "të tjerëve".

Atehere pra eshte provuar se Tafil Shabani nuk ka qelluar më shumë se sa një plumb qe ka goditur Shalen në këmbë gjatë dy-luftimit për pushken dhe që te shtënat e tjera kane gene vetem ato te Mules, katër në numër. Kjo gjithashtu mbështetet nga deklarata e Fadil Xanit i cili ka dëgjuar 4-6 të shtëna. Ai vijon se një nga katër të shtënat e Mules goditen dhe vrane Tafil Shabanin. Neni 146 i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, përshkruan vrasjen si "kushdo që e privon personin tjetër nga jeta e tij ose saj" Veprimet e Mules perkojne me këtë përshkrim ligjor.

3. Dëshmi në lidhje me Pronësinë e paautorizuar, kontrollin, posedimin dhe përdorimin e armës nga Njazi Mula

Mula u pranoi fajesine për posedim të paautorizuar të armëve, ne kete rast TTM-57 numer serik 863307. Deklarata e fajesise është mbështetur nga deklaratat e Fadil Xanit, Gecit dhe Selimit.

4. Provat lidhur me vrasjen nga Rasim Shala

Hajdini ka deklaruar se Shala tërhoqi një armë, por ai nuk ka shtene mbi Tafil Shabanin. prova mjeko-ligjore e mbështet deklaraten e Hajdinit, pasi nuk jane gjetur gëzhojat ne vendngjarje që përkojne me armën e Shalës, TTM-57 me numer serial C57818.

Dëshmitari Leku dëshmoi se arma e dores qe ai u pa njerëzve të shtrirë në tokë ishte e shkarkuar, e hapur. Në dëshminë e tij Mula nuk përmend që Shala ka shtene në Tafil Shabanin. Në fakt, Mula nuk permend qe Shala te kete patur arme fare.

Nuk ka dëshmi që tregon qëllim nga ana e Shalës për të kryer veprën e Vrasjes e as që është e vërtetuar se ai në thelb ka kontribuar në kryerjen e kesaj. Shala thjesht reagoi në situatën që ai e gjeti veten dhe u përfshi në një perleshje për armën e mbajtur nga Tafil Shabani, viktimë. Gjatë dy-luftimit arma ishte shkarkuar në një mënyrë dhe ai u plagos. Kjo luftë për një armë nuk përbën qëllim apo kontribut për krimin. Prandaj, kushtet e veprës penale nuk janë përcaktuar. Prandaj Gjykata konstaton se provat e paraqitura për të gjetur Shalën fajtor si një bashkë-kryes në vrasjen e Tafil Shabanit janë të pamjaftueshme.

5. Prova lidhur me mbajtjen në pronësi, kontroll, posedim dhe përdorimin e paautorizuar të armëve nga Rasim Shala

Ramiz Shabani dëshmoi që të dy Mula dhe Shala rregullisht kanë mbajtur arme të pargjistruara me vete dhe në zyrat e tyre. Hajdini dëshmoi se ai e pa Shalën të nxirrte pistoletën e tij jashtë. Geci dëshmoi se ai pa një pistoletë TT, në anën e djathtë të personit të shtrirë poshtë [Shala], rreth ½ metër prej tyre.

Leku dëshmoi se personi sipër [prandaj Tafil Shabani] po mbante një pistoletë në dorën e djathtë. Kjo nuk është në përputhje me deklaratën e Gecit i cili ishte nga te paret nga ata që ju afroan njëzëzve të shtrirë në tokë. Është gjithashtu e pabesueshme që Tafil Shabani kishte një pistoletë në një anë, një pushkë e gjatë me një bajonetë të bashkangjitur në anën tjetër dhe duke luftuar me Shalën në të njëjtën kohë. Është edhe më e pabesueshme në atë që Leku jo vetëm që deklaroi se Shabani kishte një pistoletë në një dorë, por në të njëjtën kohë ai theksoi se Shabani (ai permby), i kishte të dy duart rreth fytyrës së Shalës. Këto deklarata janë të paqëndrueshme dhe disi kontradiktore. Sipas deklaratës së tij Leku ishte mik i ngushtë me Ramiz Shabanin, Shala dhe Mula. Kjo mund të ketë ndikuar dëshminë e Lekut sa i përket si cili ishte duke e mbajtur armën. Gjykata vëren më tej se nuk ka të dhëna që viktimë Tafil Shabani të kishte një armë të tillë. Është edhe krejtësisht e palogjikshme që ai do të kishte shkuar për të nxjerre një pushkë rëndë nga kepegu i makines ose edhe poshtë sediljes së automjetit në rast se ai kishte një pistoletë mbi vete.

Gjykata konstaton se dëshmitë e Ramiz Shabanit, Hajdinit dhe Gecit janë të mjaftueshme për të bindur panelin që Shala është fajtor për veprën penale të posedimit të paautorizuar të armës TTM-57, numri serial C57818.

6. Mocionet e e refuzuara

Avokati Haxhi Millaku i kërkoi Gjykatës të inspektuar vendin e krimit për të hulumtuar, në mënyrë që kolegji të ketë pamjen e vërtetë të saj dhe për të kuptuar objektivistikisht këtë çështje. Për shkak të skemës së detajuar dhe fotografive të paraqitura si dëshmi nga Prokurori Publik Paneli ka informacion të mjaftueshëm të vendngjarjes. Vizita në vendin e ngjarjes nuk do të sjellë informata shtesë të rëndësishme. Prandaj paneli vendosi ta refuzojë këtë kërkesë.

Avokati Xhelal Hasani ka kërkuar që deklaratat e Musa Gashit dhe Muharrem Lekut të dhëna në polici më 3.9.2008 të konsideroheshin të lexuara. Gjykata e hodhi poshtë këtë kërkesë për shkak se dëshmitarëve nuk i'u është dhënë rasti që të refuzojnë për të dëshmuar, siç përcaktohet në nenin 160 të KPPK-se.

E. KUALIFIKIMI LIGJOR

1. Ligji i aplikuar

Veprat penale janë kryer më 2 shtator 2008. Në atë kohë Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës (KPPK), që hyri në fuqi më 06 prill 2004, ishte ligji në fuqi. Në bazë të nenit 2 paragrafi (1) të KPPK-së, ligji në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, do të zbatohet për kryerësit, përveç nëse zbatimi i një ligji të mëvonshëm do të ishte më i favorshëm për të akuzuarit. Nuk kishte asnjë ndryshim në ligj që do e bënte atë më të favorshëm për të akuzuarit. Edhe pse të akuzuarit u akuzuan sipas "Kodit Penal të Kosovës" (LPK), ndryshimi në ligjin që ka hyrë në fuqi më 06 janar 2009 dhe futur këtë emër të ri të kodifikimit penal nuk përmban asnjë ndryshim material që ka lidhje me këtë rast. Dispozitat e aplikueshme në këtë rast, kanë mbetur po të njëjta.

2. Mbrojtja e domosdoshme

Mbrojtja e Mules ishte se ai nuk ka shtene ne Tafil Shabanin, por në ajër. Siç u tha më lart, është vërtetuar se i akuzuari Njazi Mula shkaktoi vdekjen e Tafil Shabanit dhe ndoshta lëndime të rënda Rasim Shales.

Gjykata shqyrtoi nëse aktet e Njazi Mules mund të ketë rënë nën fushëveprimin juridik të mbrojtjes së nevojshme. Sipas nenit 8 paragrafi 2 i LPK-së një akt është kryer në mbrojtje të nevojshme, kur një person kryen aktin për të shmangur një sulm të paligjshëm, real dhe të menjehershëm nga vetja ose një person tjetër dhe kur natyra e veprës është në proporcion me shkallën e rrezikut që paraqitet nga sulmi. Gjykata gjeti se në rastin përpara saj elementet përbërës të mbrojtjes së nevojshme nuk ishin të pranishëm.

Eshte e padiskutueshme, qe të dy Mula dhe Shala shkuan në takim me arme me vete gati për t'u përdorur, që lehtë tregon një pozicionim konfrontues, nëse jo provokues. Ky tregues perforcohet nga incidenti paraprak i atyre të dyve duke i treguar armët ne menyre kercenuese Ramiz Shabanit më herët atë ditë. Përsa i përket kursit te veprimit në vendin e ngjarjes, Hajdini ka deklaruar se Tafil Shabani u armatos vetëm, pasi pa armët e Mules dhe Shales. Eshte e pamohueshme se Hajdini ishte i paarmatosur.

Mula ka deklaruar se ndërsa ai dhe Shala kanë hyrë ne parkingun e makinave Tafil Shabani e mori pushkën me tyte te gjatë qe ishte nen ulesen e tij. Siç u tha më parë,

Gjykata konstaton se nuk ka gjasa, ose eshte gati e pamundur që një pushkë e gjatë të mund te ketë qenë e ruajtur dhe nxjerrë në ndonjë mënyrë të arsyeshme të shpejtë nën sediljen e pasme të këtij automjeti. Prandaj, Gjykata konstaton se eshte paprovuar se Mula dhe Shala kanë qenë ne kërcënim në atë kohë kur ata arritën në vendin e të shtënave.

Mula pohoi se ai nxori nga mesi revolen e tij vetëm pasi ai kishte pare Tafil Shabanin te shtinte kundrejt Shales. Meqë Mula ka deklaruar më parë se ai e ka mbajtur armën e tij për mbrojtjen e tij Gjykata konstaton se nuk ka gjasa që ai do të shikonte qe po shtihej kundrejt mikut te tij e të mos e përdorte, ose të paktën te mos e nxirrte pistoleten e tij. Deklarata e Mules eshte gjithashtu e pabesueshme ne ate qe pistoleten e mbante ne "kutine e shpejtesive" (kutine e nderrimit te marsheve) te makines se tij. Në qoftë se ishte keshu, si e ndodhi që papritmas kjo u vendos në rripin e tij ndersa po dilte nga makina. Historia e tij sa i përket vendndodhjes se armes se tij dhe te Tafil Shabanit, sjell dyshime serioze për dëshminë e tij.

Sipas deklaratës se Mules, Shala ishte i pari që veproi në këtë situatë pasi ai kerceu dhe mori pushkën e Tafil Shabanit. Vetëm pas kësaj arma u shkarkua dhe e goditi Shalen në këmbë. Hajdini dha dy versione të dy-luftimit mbi armën, një ku deklaroi se Shala ishte qelluar një here në këmbë dhe më pas ai mori pushkën, dhe një duke deklaruar se Shala u hodh mbi pushkën, ata luftuan dhe pastaj Shala u qëllua në këmbë. Gjykata pranon se në një rast kur një person kapet papritmas në një situatë të rrezikshme për jetën ndoshta perceptimet e tij dhe kujtimet per situatën mund të jetë te cenuara. Pikërisht kjo këtë përshkroi Azem Hajdini, kur ai deklaroi se ai "ka humbur veten". Prandaj Gjykata konsideron deklaratën e Mules, Shala ka vepruar i pari, sic eshte provuar. Për më tepër, qe të dy Hajdini dhe Mula deklaruan se Mula vetëm qëlloi me armë, pasi Tafil Shabani kishte shtenë në këmbën e Shales dhe, ndërsa ata ishin duke luftuar për armën.

Në përfundim, Gjykata deklaroi se nuk ka pasur sulm nga Tafil Shabani kundrejt Mules ose ndonjë tjetri. Ne fakt Tafil Shabani eshte konfrontuar nga dy burra te armatosur dhe me pas eshte sulmuar nga Shala i cili i mori pushken e u perllesh me Tafil Shabanin duke shkaktuar shkarkimin e armes. Në këtë pikë, vetëm pas kësaj lufte, Mula ka shtene me armen e tij katër herë duke goditur Tafil Shabani një herë për vdekje.

Tashmë Tafil Shabani ishte i vetem dhe i perfshire në një luftë me Shalen dhe për këtë arsye nuk vazhdonte t'ia kishte drejtuar armen qoftë Mules apo Shales. Natyrisht e gjithë kjo mund të ishte shmangur, nëse askush nuk erdhi i armatosur në këtë diskutim të thjeshtë. Per shak se të gjithë ishin të armatosur, një është i vdekur, një paaftë për jetë dhe tjetri përballe vepres se rëndë penale të vrasjes. Kjo është pikërisht arsyeja pse ligji e ndalon vringellimin e armëve te zjarrit permes dënimeve të rënda dhe pse ata që i vringellojne armët e zjarrit nuk mund të kërkojnë mbrojtjen e nevojshme, kur kundërshtari i tyre i përgjigjet duke shtene me arme.

Prandaj, Gjykata e përjashton këtë mbrojtje.

F. PERCAKTIMI I DENIMIT

Ne shqiptimin e sanksionit penal Gjykata duhet të mbajë në mend dy qëllimet e përgjithshme të dënimit - që është për të shtypur veprimtarinë shoqërore të rrezikshme duke frenuar të tjerët nga kryerja e veprave të ngjashme penale, dhe me qëllim të veçantë - për të parandaluar kryerësit nga ri-perseritja e veprës penale. Në përcaktimin e kohëzgjatjes së dënimit, Gjykata ka për të vlerësuar të gjithë faktorët lehtësues dhe rëndues, sipas nenit 64 (1) të KPPK-së.

Për veprën penale të Vrasjes në pajtim me nenin 146 të KPPK, ligji parashikon një dënim prej së paku pesë vjet burgim.

Për veprën penale të mbajtjes në pronësi, kontroll, posedimit ose përdorimit të paautorizuar të armëve, sipas nenit 328 (2) të KPPK-së, ligji parashikon një dënim deri në 8 vjet burgim.

Në rastin e vrasjes së kryer nga Mula kolegji mori si një faktor lehtësues faktin se ka pasur një perleshje në të cilën janë përfshirë 3 persona me armë, se ai nuk e ka inicuar këtë takim, se shoku i tij ishte plagosur dhe se ai mund të ketë mbi-reaguar në situatë.

Ne rast të mbajtjes të paautorizuar të armës nga i akuzuari Mula kolegji mori si një faktor rëndues faktin që ai ka mbajtur armë në posedim të tij për të paktën 10 vjet, e ka mbajtur të mbushur me vete dhe nga sa duket nuk e sheh që ligji kundër ceshtjeve të tilla dhe pasojat e rënda të përdorimit të armëve në këtë rast të veçantë janë perkates për të.

Duke marrë parasysh faktorët lehtësues, kolegji vendosi 5 vjet burgim për veprën penale të vrasjes në rastin e Mules. Duke marrë parasysh faktorët rëndues, kolegji vendosi 4 vjet burgim për veprën penale të mbajtjes në pronësi, kontroll, në posedim ose përdorim të paautorizuar të armëve në rastin e Mules. Në bazë të nenit 71 paragrafi (1) dhe paragrafi (2) pika 2 të KPPK-se kolegji përcaktoi dënimin unik me shtatë vjet burgim.

I akuzuari Mula është në paraburgim nga 2 shtator 2008 deri më 17 shkurt 2010 dhe më pas nën masat e sigurisë të arrestit shtëpiak. Kjo periudhë duhet të kreditohet në dënimin e shqiptuar me burgim sipas nenit 73 (1) të KPPK-së.

Në rast të posedimit të paautorizuar të armës nga i akuzuari Shala kolegji mori si një faktor lehtësues faktin se arma e tij duhet të ketë qenë e pambushur gjatë tërë kohës, pasi nuk u gjeten gezhoja, ai ishte nën kontrollin e superiorit të tij, edhe pse nuk ishte në detyrë, dhe u plagos rëndë si rezultat i këtij aktiviteti.

Duke marrë parasysh faktorët lehtësues, kolegji përcaktoi 2 vjet burgim për veprën penale të mbajtjes në pronësi, kontroll, posedim apo përdorimit të paautorizuar të armëve

në rastin e Rasim Shales.

Kolegji ka konfiskuar te treja armët që janë përdorur në ditën e ngjarjes.

G. SHPENZIMET

I akuzuari Njazi Mula dhe i akuzuari Rasim Shala u gjetën fajtorë, prandaj, ata duhet të rimbursojnë shpenzimet e procedurës penale në pajtim me nenin 102 paragrafi (1) të KPPK-se, përveç shpenzimeve të përkthimit gjatë procedurës penale. Një vendim i veçantë mbi shumën e shpenzimeve do të përcaktohet nga Gjykata, kur këto të dhëna të merren në pajtim me nenin 100 paragrafi (2) i KPPK-se.

H. KERKESA PER KOMPENSIM

Në fillim të gjykimit kryesor, i dëmtuari u informua se ai mund të paraqesë një mocion për të realizuar kërkesën pronësore në kuadër të procedurës penale, në pajtim me nenin 355 paragrafi (2) të KPPK-se.

Pala e demtuar Ramiz Shabani nuk ka bërë kërkesë për të realizuar kërkesën pronësore.

Gjykata e Qarkut e Mitrovices
P. nr. 17/09

Pergatitur ne Anglisht, ne gjuhen e autorizuar.

Kryetar i Kolegjit Anetare e Kolegjit Anetare e Kolegjit
Charles Smith Caroline Charpentier AgnieszkaKlonowiecka-Milart

Procesmbajtese
Noora Aarnio

Keshille Ligjore:

Personat e autorizuar mund të paraqesin ankesë me shkrim kundër këtij aktgjykimi përmes Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës për Gjykatën Supreme të Kosovës brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga data e marrjes së kopjes së aktgjykimit.